



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

REAGIM

Lidhur me Akademinë Përkujtimore mbi figurën e Xhafer Devës

Ditëve të fundit, në mediumet dhe rrjetet sociale të Kosovës, po shpërndahet njoftimi lidhur me organizimin e një akademie përkujtimore lidhur me figurën e Xhafer Devës, me mbishkrimin e Institutit të Historisë.

Me këtë rast, njoftojmë opinionin publik se emri i Institutit të Historisë është keqinterpretuar. Në njoftimin për akademinë përkujtimore figuron emërtimi Institutit të Historisë vetëm duke iu referuar ndërtesës, e jo institucionit organizues, prandaj, këtu qëndron keqinterpretimi.

Instituti i Historisë nuk qëndron prapa këtij evenimenti, e as nuk është përfshirë në çfarëdo forme apo mënyrë në organizimin e tij. Instituti i Historisë nuk menaxhon me sallën dhe objektin ku është planifikuar të mbahet ky aktivitet.

Instituti i Historisë nuk mund t'i mohojë askujt të drejtën e shprehjes dhe të mendimit të lirë, e as të organizimit të evenimenteve të ndryshme, qofshin ato të karakterit kulturor apo shkencor. Në këtë kontekst, Instituti i Historisë të gjitha aktivitetet shkencore i organizon në bazë të agjendës vjetore dhe si të tilla ato mbahen nën siglën e Institutit.

Prishtinë, më 29.4.2022

Prof. as. dr. Armend Mehmeti

Sekretar Shkencor i Institutit të Historisë